

I nderuar Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Rusi,

E nderuara znj, Tarletti, Shefe Sektori e Drejtësisë, Punëve të Brendshme dhe Mirëqeverisjes, Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri,

Të nderuar të ftuar,

Të dashur kolegë të trupës gjyqësore dhe ndihmësa ligjorë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,

Më lejoni t'ju uroj mirëseardhjen në këtë aktivitet të rëndësishëm ku do të prezantojmë analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP) për vitin 2024,

Ndihemi të privilegjuar të kemi prezencën tuaj këtu sot, një tregues për rëndësinë e kësaj gjykate dhe vendin që ajo zë në sistemin gjyqësor shqiptar, por edhe për rëndësinë që kanë tanimë vështirësitë e shumta që ajo përballon që prej fillimit të funksionimit të saj në shkurt të vitit 2023.

Raporti vjetor që kemi përpara përshkruan veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të gjykatës gjatë vitit 2024, vitit të dytë të funksionimit të saj, duke evidentuar rezultatet e arritura në drejtim të gjykimit të çështjeve por edhe vështirësitë strukturore dhe infrastrukturore që përbëjnë sfidat kryesore të kësaj gjykate, si gjykata e vetme në nivel apeli për juridiksionin e përgjithshëm (civil dhe penal) në Republikën e Shqipërisë.

Më lejoni ta nis këtë analizë pune me një lajm të mirë. Pas dy vitesh të plota funksionimi, Gjykata do të mund të zgjerojë vendndodhjen e saj duke pasur një godinë të dedikuar për seksionin civil të kësaj gjykate. Në datë 20.03.2025, Gjykata ka marrë tashmë në administrim për t'u përdorur për ushtrimin e aktiviteteve administrative të saj, ish godinën e tatimpaguesve të mëdhenj.

Ky lajm është domethënës dhe tregon vëmendjen që tanimë po gëzon kjo gjykatë edhe nga organet e tjera në vend. Megjithatë, sikurse e përmenda, vështirësitë mbeten të mëdha dhe kjo gjykatë ka nevojë për një mbështetje të gjerë, gjithëpërfshirëse institucionale që të arrijë misionin e saj, dhënien e drejtësisë, në kohë të arsyeshme, duke rikthyer besimin e qytetarëve shqiptarë në drejtësinë në vendin tonë.

Gjatë vitit 2024 kanë ushtruar detyrën efektivisht 26 gjyqtarë mesatarisht, të cilët kanë kompetencë tokësore mbi gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pavarësisht prurjeve të reja që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor që gjej rastin ta falenderoj për mbështetjen e pakushtëzuar, përsëri ky numër është larg plotësimit të strukturës aktuale prej 78 gjyqtarë, që do t'i mundësonte një frymëmarrje normale kësaj gjykate, arritjes së pritshmërive të reformës së hartës gjyqësore për një standardizim të gjykimit në nivel apeli, ngarkesës së ekuilibruar të gjyqtarëve në këtë nivel përkundër mesatares kombëtare vjetore të gjykimit të çështjeve prej 253 çështjesh gjyqësore për gjyqtar në vit në mënyrë që të realizohet gjykimi i çështjeve në një afat sa më të shpejtë kohor dhe uljes së numrit të çështjeve të prapambetura (backlog-ut).

Aktualisht mesatarja e çështjeve gjyqësore për gjyqtar ka qenë 534 çështje, me 9850 vendime gjyqësore të dhëna në vit, ndërsa numri i çështjeve të prapambetura arrin në 41700 çështje.

Pavarësisht vështirësive, numrit të reduktuar të gjyqtarëve, mungesës së ndihmësve ligjorë dhe infrastrukturës së pamjaftueshme e të papërshtatshme, gjatë vitit 2024 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përballuar një volum shumë të madh pune duke sjellë një përmirësim të lehtë të situatës lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore të shqyrtuara apo në përgjithësi të të gjithë treguesve të performancës, shenjë e dedikimit të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ të gjykatës, të cilet gjej rastin t'i falenderoj. Gjithashtu, dua të falenderoj për mbështetjen që kanë dhënë në gjykatë edhe pse për një kohë të shkurtër Nepunësit për Uljen e Çështjeve të Prapambetura dhe anëtarët e tjerë të projektit, ndihmë e vyer edhe e vlerësuar nga të gjithë ne.

Megjithatë procesi i uljes së stokut vijon të mos jetë në hapat e duhura dhe pavarësisht përpjekjeve ai vjen në rritje për aq kohë sa numri i gjyqtarëve efektivë në detyrë qëndron pothuajse i njëjtë.

Norma e likuidimit të çështjeve për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme as në rezultatet e arritura në fund të vitit 2024, edhe pse vjen në përmirësim të lehtë. NLÇ për vitin 2024 në GJAJP rezulton në nivelin 71%, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2023 ku NLÇ ishte 68% por ende larg standardit ndërkombëtar.

Megjithatë nëse kjo e dhënë ndërthuret me tregues të tjerë si numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë, vlen të theksohet se GJAJP ka arritur të evadojë afro 70% të

ngarkesës me vetëm afro 30% të trupës gjyqësore në shërbim. Gërshetimi i këtyre treguesve nxjerr në pah edhe njëherë gatishmërinë dhe përkushtimin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ të GJAJP për t'u shërbyer qytetarëve, pavarësisht vështirësive objektive.

Mirëpo ky rezultat tregon nga ana tjetër edhe se gjykata, për shkak të vakancave, nuk është në gjendje të menaxhojë plotësisht ngarkesën e re të ardhur dhe vijon jo vetëm të mos evadojë stokun e çështjeve të prapambetura, por të akumulojë gjithnjë e më shumë ngarkesë.

Në analizë të këtyre treguesve do të arrinim në konkluzionin se nëse sot GJAJP do të funksiononte me 100% të trupës gjyqësore, brenda dy vjetesh do të evadohej tërësisht jo vetëm backlog-u, por edhe çështjet e reja të regjistruara.

Prandaj, plotësimi i trupës gjyqësore prej 78 gjyqtarësh dhe vendosja në funksionalitet të plotë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si e vetmja mënyrë për t'ju përgjigjur qytetarëve shqiptarë për dhënien e drejtësisë në kohë dhe me cilësi duhet të jetë prioriteti kryesor i Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjatë vitit 2025. Madje ka ardhur momenti ku ky prioritet të tejkalojë qeverisjen e gjyqësorit dhe të ngrihet në një prioritet kombëtar e në fokus kryesor jo vetëm të institucioneve të pavarura me të cilat gërshetohet procesi i promovimit të gjyqtarëve, por edhe të ekzekutivit dhe Kuvendit të Shqipërisë, duke vendosur të gjitha burimet e nevojshme në dispozicion.

Ju Faleminderit !